VENDIM
Nr. 24, datë 10.2.2020

MBI PROCEDURËN E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR NGA FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË, FTL SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 11, pika 2, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë Teknike, në lidhje me procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga ana e FTL sh.a., në zbatim të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 244, datë 30.3.2016, 'Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike', të ndryshuar",

konstatoi se:

- Shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" "FTL" sh.a., është licencuar nga ERE në aktivitetin e tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, respektivisht me vendimet nr. 198, datë 3.9.2018, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Furnizuesi i Tregut të Lirë' sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike" dhe nr. 199, datë 3.9.2018, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Furnizuesi i Tregut të Lirë' sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".

- FTL sh.a., me shkresën e saj nr. 235 prot., datë 24.1.2020 dhe protokolluar me tonën nr. 140 prot., datë 27.1.2020, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar dhe pa platformë shitje energjie online.

- Sa më sipër, FTL sh.a. argumenton se kjo kërkesë vjen si nevojë e marrjes së masave të nevojshme për tregtimin e tepricave të prodhuara nga PPE-të, në treg të parregulluar, në muajt kur prodhimi i PPE-ve tejkalon sasinë e energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, pavarësisht se janë të pakët.

- Kërkesa e mësipërme vjen si rezultat i ndryshimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, me VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, nenit 11, pikat 2 dhe 3, si më poshtë:

2. "Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE….".

- Sa përcaktuar në VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, vendos ERE-n para detyrimit për miratimin e rregullores për tregtimin e energjisë elektrike.

- Nisur nga:

- emergjenca e procesit, pasi mund të ndodhemi përpara një situate me reshje dhe historiku ka treguar se Prodhuesit me përparësi të Energjisë Elektrike gjatë muajve shkurt–prill arrijnë prodhimin e tyre maksimal, ç'ka mund të gjenerojë nevojën për zhvillimin e procedurave të tregtimit të tepricave të energjisë elektrike nga kjo kategori;

- koha e shkurtër për përgatitjen e një rregulloreje të tregtimit të energjisë elektrike dhe kalimit të fazave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e një akti normative;

- mungesa e një platforme shitjeje të energjisë nga ana e FTL sh.a. dhe kohës së nevojshme për krijimin e saj;

- KESH sh.a. me vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit sh.a. ka miratuar "Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a." që përmbush detyrimin për zhvillimin e këtyre procedurave duke ruajtur parimet e barazisë dhe transparencës nëpërmjet procedurave elektronike (komunikimi *via email*).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Për një periudhe tranzitore, deri në miratimin e rregullave të tregtimit të Energjisë elektrike, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të përdorë "Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a." të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

2. Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. të propozojë për miratim në ERE, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullat për tregtimin e energjisë elektrike të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe energjisë, si dhe Autoritetin e Konkurrencës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti